Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 4.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar, sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;

b. Deklaratën për paraqitje oferte të pavarur sipas Shtojcës 1/1;

c. Deklaratën mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 4/1;

ç Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 6;

d. Deklaratën mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;

dh. Formular vlerësimi sipas Shtojcës 8;

e. Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 9 ;

f. Deklaratë mbi kontratat e lidhura apo në proces sipas Shtojcës 10;

g. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

2. Për të provuar përmbushjen e kapaciteteve të mëposhtme, Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Per kapacitetin ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

- Sipas kritereve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit (Shtojca 11)

2.2. Per kapacitetin ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuara të bilanceve të **3** (tre) viteve të fundit ushtrimore (**2018, 2019, 2020**), të paraqitur në autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar.
2. Kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë **3** (tre) viteve të fundit ushtrimore (**2018, 2019, 2020**) lëshuar nga autoriteti përkatës, vlera mesatare e se ciles duhet të jete jo me e vogel se 50% e vlerës së fondit limit perkatesisht.
3. Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2020 dhe 2021, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas përcaktimeve të Ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar);

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

2.3 Per kapacitetin teknik:

**Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:
Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:**

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet të realizuar gjatë tri viteve të fundit.

- b. Punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit është në një vlerë sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet lekë pa TVSH.

Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

1.2 Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara **me ente publike**, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Formular vleresimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
 - Kontratë Sipërmarrje
 - Situacionin përfundimtar;
 - Akt-kolaudim
 - Certifikate e marrjes ne dorzim.
 - Fatura Tatimore
- b) Për kontrata të realizuara me **sektorin privat**, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Formular vleresimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
 - Kontrate Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Fatura tatimore per cdo situacion punimesh.

Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontraten e bashkimit te operatoreve dhe prokuren e posacme te deklaruar ne fazen e tenderimit; Per kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontratën baze ndermjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe Miratimi zyrtar si nenkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Operatorët ekonomike duhet të disponojnë *Liçensen e Shoqërisë*, e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin licencën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi".

Keto Licenca duhet të leshohen nga Institucionet përkatëse.

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë licencat e mëposhtme

- c. Liçenca e shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

- N.P – 1 B (Punime gjurmimi në tokë)
- N.P – 4 B (Rruge ,autostrade,.....)
- N.P – 7 C (Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje)
 - N.P – 12 B (Punime të inxhinierisë së mjedisit).
 - N.P – 10 A Ndertim impiante për prodhim energji

PUNIME SPECIALE NDËRTIMI

- N.S - 1A (Punime prishje ndertimore)
- N.S - 18 B (Punime topogjeodezike)
- N.S - 20 A (Shpime gjeologo-inxhinierike)
- Sipas modelit të lëshuar nga MPPT/MTI;

Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

2. Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë i shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme:
 - a) Kontratë pune e vlefshme (përkatëse)
 - b) Diplomë
3. Një punësim mesatar i të paktën **80 (Tetëdhjete)** punonjës me kohe të plote, për periudhën **Prill 2020 - Mars 2021**, të vërtetuar me:
 - a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; për periudhën **Prill 2020 – Mars 2021**.
 - b. Liste pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi për periudhën **Prill 2020– Mars 2021**, konfirmuara nga institucionet përkatëse.

4. Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, librezat e punës, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën **Prill 2020 – Mars 2021** stafi inxhinierik si më poshtë:

- 1(një) inxhinierë Ndërtimi
- 2(dy) inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshaidet/Gjeomatik.
- 2(dy) inxhinier Hidroteknik
- 2(dy) inxhinier Mjedisi
- 1(nje) inxhinier Mjedisi(Profili energjistik)
- 2(dy) inxhinier Gjeolog
- 2(dy) inxhinier Elektrik
- 1(një) inxhinierë Mekanik

5. Krahas stafit të mesiperm të këte të punësuar staf mbështetës si më poshtë:

- 1 (nje) Inxhinier Ndertimi Profili infrastrukture transporti
- 1 (nje) Inxhinier Ndertimi Profili Strukturist
- 4 (kater) punonjës teknik Ndërtimi
- 1 (nje) punonjës teknik Hidraulik
- 1 (nje) punonjës teknik Gjeometer
- 1 (nje) agranom
- 3 (tre) punonjës teknik Mekanik
- 1 (nje) punonjës teknik Topograf
- 1 (nje) punonjës pllakashtrues
- 1 (nje) punonjëselektracist

*Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata noetriale e punës e vlefshme deftes e shkolles profesionale / ose vertetim i leshuar nga shkolla profesionale shtetërore per secilin punonjes. Stafi i mësipërm të figuroje ne listepagesat e shoqërisë për periudhën **Prill 2020 - Mars 2021**. Mos paraqitja e kontrave të nënshkruara përpara noterit mes paleve kontratore do të jetë kusht skualifikues:*

Ne rastin e paraqitjes së kontratave kolektive detyrimisht të jenë konform nenit 160 të Kodit të Punës sipas parashikimeve ligjore në fuqi.

6. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve, si më poshtë:
- 2 (dy) punonjës Karpentier
 - 3 (tre) punonjës Murator
 - 1 (nje) punonjës Hekur kthyes
 - 1 (nje) Specialiste ndertimi
 - 3 (tre) Hidraulik

*Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata noteriale e punës e vlefshme; deshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik, (të vlefshme), deshmitë e aftësisë profesionale deftese/certifikate/diplomesi dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën **Prill 2020 – Mars 2021**.*

7. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht: 5(pese) Eskavatorist/Manovrator, 2(dy) automakinist, 5(pese) shofere, Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata noteriale e punës e vlefshme, dëshmitë e drejtimit (të vlefshme), deshmitë e aftësisë Profesionale (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në list-pagesat e shoqërisë për periudhën **Prill 2020 – Mars 2021**.

8. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar **1(një) mjek** të përgjithshëm, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Liçense për ushtrimin individual të profesionit, diplomë, librezë pune dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën **Prill 2020 – Mars 2021**. Në rastin e bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) mjek të përgjithshëm. (Në mbështetje të VKM Nr. 692 datë 13.12.2001 ndryshuar me VKM Nr. 742, datë 06.11.2003 “Për masat e vecanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë”, Neni 12/1 Operatorët ekonomik pjesëmarrës që kanë të punësuar më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës nuk kanë detyrim ligjor plotësimin e kërkesës së mësipërme.)

9. Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se ka pjesë të stafit të shoqërisë një Inxhinier që përmbush kriteret për të qenë koordinator për **realizimin e punimeve në fushën e sigurisë dhe të shëndetit gjatë realizimit të punimeve**, i cili duhet të jetë i pajisur me certifikatë/dëshmi trajnimi (specialist për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë) që tregon pjesëmarrjen e tij në kurse specifike për sigurinë, të organizuara nga subjekte të njohura publike ose private, sipas kërkesave të ligjit nr. 10237 date 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M. nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”. të shoqëruar me kontratë pune noteriale të vlefshme. Libreze pune, Diplome, CV si dhe të figurojnë në list-pagesat e shoqërisë.

10. Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të preventivit.

11. Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 9).

Dokumenta Standarde të Tenderit

Nr/R	Mjetet	Sasia	Gjendja
1	Kamiona veteshkarkues kapacitet mbajtes(10-12 ton)	2 copë	Pronësi ose me qera
2	Kamiona veteshkarkues kapacitet mbajtes mbi 20 ton	3 copë	Pronësi ose me qera
3	Kamionçine kapacitet mbajtes(1.5-2 ton)	2 copë	Pronësi ose me qera
4	Kamiona veteshkarkues kapacitet mbajtes(3-5 ton)	4 copë	Pronësi ose me qera
5	Autofshese per pastrim rruges	1 copë	Pronësi ose me qera
6	Sistem ëellpoint/ekuivalentpërheqjeujrash	2 copë	Pronësi ose me qera
7	GPS	1 copë	Pronësi ose me qera
8	Grejder (me targa)	2 copë	Pronësi ose me qera
9	Kamion me Vinckapcitet mbajtes(6.5-8.5 ton)	2 copë	Pronësi ose me qera
10	Autoskrep/Fadrome me goma	3 copë	Pronësi ose me qera
11	Eskavator me goma (me targa)	3 copë	Pronësi ose me qera
12	Autobot uji	2 copë	Pronësi ose me qera
13	Cekic pneumatik per prishje	1 copë	Pronësi ose me qera
14	Betoniere kantieri 2.5 m3	1 copë	Pronësi ose me qera
15	Minieskavator me zinxhir	1 copë	Pronësi ose me qera
16	Vibrator	1 copë	Pronësi ose me qera
17	Autobitumatrice	1 copë	Pronësi ose me qera
18	Rimorkiator	1 copë	Pronësi ose me qera
19	Betonjere kantieri	3 copë	Pronësi ose me qera
20	Kompresor	1 copë	Pronësi ose me qera
21	Tokmak vibrues	1 copë	Pronësi ose me qera
22	Gjenerator	2 copë	Pronësi ose me qera
23	Mini fadrome	1 copë	Pronësi ose me qera
24	Makineri vijeziimi bikoponente	1 copë	Pronësi ose me qera
25	Autobetoniere per pergatitjen e betonit	2 copë	Pronësi ose me qera
26	Autopompe per hedhje betoni	1 copë	Pronësi ose me qera
27	Matrapik	2 copë	Pronësi ose me qera
28	Armature per betonet	1000 m2	Pronësi ose me qera
29	Rrul me peshe 0-1 ton per trotuar dhe pankinat	1 copë	Pronësi ose me qera
30	Asfaltoshtruese	1 copë	Pronësi ose me qera
31	Rrula 5-12 tone	3 copë	Pronësi ose me qera
32	Autobot per KUZ (shoqeruar dhe me qkl kodi III.1.A)	1 copë	Pronësi ose me qera
33	Aparat saldimi me elektrofuzion per ngjitje tub plastik	1 copë	Pronësi ose me qera

Mjete dhe paisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit në zbatim të VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 Per miratimin e rregullores "Per sigurine ne kantier" i ndryshuar, si më poshtë vijon:

- Kokore minimumi 70 copë
- Jeleke Fosforeshente minimumi 30 copë
- Doreza pune minimumi 30 copë
- Komplet i ndimës së shpejtë minimumi 10 copë

- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 20 copë

Të gjitha mjetet e lartpërmendura duhet të jenë shoqëruar me fotot përkatëse.

Mjetet e lartpërmendura duhet të jenë në pronësi ose me qera dhe ofertuesi duhet të paraqesë deklarin për disponimin e makinerive (sipas shtojcës 9) të shoqëruar me dokumentat e mëposhtëm:

- a) ***Aktin e pronësisë së mjetit përkatës:*** Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, plus taksa e mjetit dhe siguracionin e mjetit (të vlefshme) si dhe certifikaten e transportit, leje transporti, licence transporti të leshuara nga autoritetet përkatëse Per subjektin.

ose

- b) ***Kontratën e marrjes me qira të mjetit,*** shoqëruar me dokumentacionin përkatës të

pronësisë së mjetit që ka pronari, i cili e jep me qira. Kontrata e qirasë të jetë noteriale dhe të jete specifike perobjektin qe prokurohet dhe afatin e realizimit të kësaj kontrate.

- *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë (mjetet me goma) duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik, plus taksa e mjetit dhe siguracionin e mjetit (të vlefshme), dhe për mjetet e siguruara me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit,(të vlefshme) si dhe certifikaten e transportit nga autoritetet përkatëse për vete dhe të tjerë,(të vlefshme)duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse të qerasë/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.*

Për secilin prej mjeteve të paraqiten fotografi të tyre.

- b) Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë se: Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera. Kjo deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese duhet të përmbajë vendndodhjen e sakte të mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi.

- **Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë në çdo kohë verifikimin fizik të disponueshmërisë së mjeteve.**

12.Kandidati ofertues duhet të paraqesë certifikatat e mëposhtme: (Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike secili nga operatorët duhet të zotërojë certifikatat e mëposhtme në përputhje me punimet e marra për siper).

Per të garantuar punime me cilësi dhe me seriozitet operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat e mëposhtme (ose të njevlefshme me to):

Dokumenta Standarde të Tenderit

- **ISO 9001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë“ lëshuar nga Institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim per garantimin e cilesise ne punime.
- **OHSAS 18001:2007** mbi “Shëndetin dhe sigurimin në punë“ lëshuar nga Institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim per mbrojtjen e shendetit dhe sigurise ne pune. **Osecertifikatë ekuivalente të njohur nga Standardet shqiptare ISO 45001-2018.**
- **ISO 14001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të ambientit“ lëshuar nga Institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim, per mbrojtjen e mjedisit dhe te sistemit.
- **ISO 1452-1:2009** mbi “Ndertimin e sistemeve te tubacioneve per transportimin e ujit, mbi dhe nen tokesore” per pjesen e kanalizimeve me presion mbi toke per tubat .
- **BS ISO 39001:2012** mbi “Sigurine ne trafikun rrugor”.
- **ISO BS EN 13331-1: 2002** Realizimi i punimeve per veshjet e kanaleve dhe skrapatave te ndryshme.
- **ISO DS CET/TR 15128:2005** Realizimi i riparimeve kanalizuese per shkarkime dhe kullime te ujrave
- **ISO 50001 2011 mbi** Sistem i Menaxhimit Energjisë për kompaninë (e vlefshme).
- **ISO 3834-4 2005 mbi** Sistem i Menaxhimi i Sigurise per Saldimet (e vlefshme).

13. Operatorët ekonomikë ,duhet kenë apo që mund t’i vihen në dispozicion

1(një) nyje thyerje materiale inert e cila duhet të jenë të pajisura me leje mjedisore kodi III.1.B,

1(një) fabrikë asfalti e cila duhet të jenë të pajisura me leje mjedisor ekodi III.1.B,

1(një) fabrike betoni e cila duhet të jenë të pajisura me leje mjedisore kodi III.1.B

1(një)fabrikë bitumi e cila duhet të jenë të pajisura me leje mjedisore kodi VIII.1.A.

Në rastin kur ka një kontratë qiraje/furnizimi me prodhuesin,bashkë me lejen mjedisore të prodhuesit, duhet të paraqitet edhekontrataeqirasë/furnizimit evlefshme. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë)epjesëmarrjes sëtyrenëbashkim.

Shenim: Per fabriken e asfaltobetonit bazuar ne VKM Nr 628 date 15.07.2015 nga koha e prodhimit, transportit, shtrimit nuk duhet qe te kaloje me shume se 2 ore ose 60 km larg objektit.

Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se ka pjesë të stafit të shoqërisë një 1 (nje) agranom me licenc sipas modelit të lëshuar nga MPPT/MTI me eksperienc mbi 10 vjet e deshmuar me Licenc, Libreze pune, Diplome, CV si dhe të figurojnë në list-pagesat e shoqërisë.

Operatori ekonomik te kete te punesuar nje eksper zjarrefikse te shoqeruar me : kontrate noteriale pune, certifikaten e zjarrefiksti, libreze pune, cv, te jete ne liste pagesa per periudhen 12 muajt e

fundit, gjithashtu operatori ekonomik ose eksperti zjarrefikes te jete te i pajisur me Kodi 1.2.A leshuar nga QKL (kjo pike kerkohet duke qene se ne objektet do perdoret praimer/bitum keto materiale konsiderohen lende e rrezikshme per zjarr).

14. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të garantojnë furnizimime materialet kryesore për realizimin e objektit të prokurimit. Konkretisht për:

a. Tubo HDPE dhe PVC. Kur operatorët ekonomikë janë prodhues të paraqitet katalogu përkatës, leje mjedisore kodi KODI III.1.B (riciklim plastic), KODI III.1.A (prodhimi I produkteve plastike), KODI III.2.B (perpunimi I plastikes) dhe certifikatëne cilësisë ISO 9001/ekuivalente e vlefshme. Kur operatorët ekonomikë nuk janë vetë prodhues të paraqitet kontrata paraprake e furnizimit vlefshme dhe katalogu përkatës, leje mjedisore KODI III.1.B (riciklim plastic), KODI III.1.A (prodhimi I produkteve plastike), KODI III.2.B (perpunimi I plastikes), certifikatën e cilësisë ISO9001/ekuivalente e vlefshme të prodhuesit .Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

b. Pllaka granili dhe bordura kur operatorëtekonmikë janë prodhues të paraqitet katalogu përkatës, leje mjedisore kodi III.1.A dhe certifikatëne cilësisë ISO 9001/ ekuivalente evlefshme. Kur operatorët ekonomikë nuk janë vetë prodhues të paraqitet kontrata paraprake e furnizimit e vlefshme dhe katalogu përkatës, lejemjedisore kodi III.1.A, certifikatën e cilësisë ISO9001/ekuivalente e vlefshme të prodhuesit.

15. Operatori ekonomik duhet te kete licence lidhur me ndikimin ne mjedis te leshuar nga QKL. Kodi III.1.A ne mbeshetje te vendimit te Keshillit te Ministrave VKM Nr. 419, Date 25/6/2014 dhe Ligj Nr. 104448, Date 9/6/2011.

16. Ne perputhje me specifikimet teknike si dhe preventivit perkates, operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim/kontrate bashkepunimi nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto pajisje/mallra në këtë procedurë prokurimi, si më poshtë.

- Hekur;
- Bojra bikomponente;
- Elektrike;
- Tabela;

Për rastin kur autorizimi do të jetë lëshuar nga distributori i autorizuar, duhet te shoqerohet edhe me dokumentacionin qe verteton lidhjet e firmes prodhuese me distributorin (kontratë/autorizim). Operatori ekonomik të paraqesë katalogjet perkatese per secilin nga produktet/mallrat e mesiperme. Gjithashtu O.E. te paraqes deklarate garancie jo me pak se 1 vit nga momenti i marrjes ne dorezim.

17. Operatori ekonomik duhet te kete licence lidhur me ndikimin ne mjedis te leshuar nga QKL. Kodi III.2.B autoriteti kontraktor kërkon që kjo të kryhet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi

Dokumenta Standarde të Tenderit

dhe konkretisht në ligjin 10081 datë 23.02.2003 , nga ku rrjedhimisht operatorët ekonomik ofertues duhet të disponojnë licencë QKL III.2.B “ Grumbullim, Transportim, Ruajtje, e mbetjeve Urbane”.

18. Operatori ekonomik duhet te kete kontrate noteriale me nje laborator testimi te betonit, i cili duhet te jete i akredituar nga organizma kombetar ose nderkombetar sipas standarteve SSH EN 12390-3:2009, SSH EN 12504-4:2008, SSH EN 12350-2:2009 dhe SSH EN 12504-2:2012

19.Operatori ekonomik pjesëmarrës në tender së bashku me preventivin duhet të dorëzoj analizë teknike për të gjithë e preventivit të ofertës. Mosparaqitja në formën e kërkuar përbën kusht për skualifikim. Bazuar në VKM Nr.514, datë 15.8.2007, “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, pika 10.

20. Cdo ofertues do te paraqese PLANIN E SIGURISE NE KANTIER

Per punimet ne objekt ne format sipas VKM nr. 692 date 13.12.2001 “Per masat e vecanta te sigurimit dhe ruajtjes se shendetit ne pune, te ndryshuar me VKM nr. 742 date 06.11.2003.sipas kerkesa, si rrethimi provizor, depozitimi i materialeve kryesore, ambientet e kantierit, rruge kalimet, tabelat e sig. teknik etj.

21.Nje Inxhinier Mjedisori qe eshte drejtues teknik, ne mbeshtje te vendimit te Keshillit te Ministrave Nr. 268 date 24.04.2003 Per ndikimin ne mjedis dhe auditimin mjedisor te paraqitet, Certificate nga Ministria e Mjedisit per vleresimin te ndikimit ne mjedis,per hartim ekspertize per probleme mjedisore,ekspert i vlersimit te ndikimit ne mjedis si dhe te jet ne listpagesat e shoqerise.

22.Deklarate e Operatorit Ekonomik se oferta e tij eshte ne perputhje me Projektin, specififikimet teknike, kushtet e kontratës, menyren e financimit si dhe te dhenat e tjera ne dokumentat e tenderit.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 12

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

PROJEKTI I ZBATIMIT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE

Përshkrim i punëve: Bashkëngjitur dokumentave të tenderit.

Grafiku i Punimeve: Bashkëngjitur dokumentave të tenderit.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Specifikimi i Materialeve, Skicimet, parametrat teknik etj:

Përshkrimi i të dhënave teknike të mallrave objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Shtojca 13

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

PREVENTIVAT E PUNIMEVE

Bashkëngjitur dokumentave të tenderit.

Shtojca 14.

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDART PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR⁴

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar Z. /Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimet Publike”.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s’kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt

< **Emri** >

⁴ Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore.

Shtojca 15

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Dokumenta Standarde të Tenderit

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [*emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues*] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [*shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*]/pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 16

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM
NË MARRËVESHJEN KUADËR**

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

2. _____

Shtojca 17

KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS Punët –Kërkesë për propozim

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Punëve të prokuruarra ne bazë të legjislacionit të prokurimit.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “Preventiv total” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotesuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.
- 2.2 “Preventiv për njësi” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njësi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.
- 2.3 “Afati i realizimit te punimeve” do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikun për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokurues.
- 2.4 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjijtjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.

Dokumenta Standarde të Tenderit

- 2.5 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.6 “Realizimi i punimeve” do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.
- 2.7 “Defekt” do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.
- 2.8 “Data e hyrjes” do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.
- 2.9 “Data e fillimit” është përfshirë në Të dhënat e kontrates. Ajo është data kur kontraktori do të fillojë punimet e ndertimit. Në se kjo nuk realizohet, “data e fillimit “do të jete dita në të cilën do të paguhet paradhenia.
- 2.10 “Pajisje” do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.
- 2.11 “Materiale” do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.
- 2.12 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.13 “Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.14 “Drejtues projekti” do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.
- 2.15 “Autoritet Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe që kontraktori punon për objektin e kësaj kontrate. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.16 “Kantier” do të thotë vendi fizik i Punimeve.
- 2.17 “Raport i inspektimit të kantierit” do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.
- 2.18 “Nënkontraktues” do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.
- 2.19 “Kontraktor” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.
- 2.20 “Standarde Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarde të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

- 2.21 “Ngritja e kantierit” do të thotë punimet e ndertimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluara, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndërtimit.
- 2.22 “Punime” do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të përkufizuara në dokumentat e tenderit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikrat e Korrupsuara, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korrupsuara. Veprimet e korrupsuara përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktori duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në kofidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktori mund t’i japë nënkontraktorit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar që nënkontraktorin të zbatojë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, kontraktori duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë që premtion ruajtjen e kofidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Prona Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t’i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t’i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t’i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga kontraktori gjatë

zbatimit të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.

- 6.3 Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Materialeve

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.
- 7.3 Për qëllime verifikimi, “origjinë” do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, bashkuar ose prodhuar. materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e kontraktorit ose nënkontraktorit që furnizon me materiale.

Neni 8: Vendimet e Drejtuesit të Projektit

- 8.1 Drejtuesi i projektit do të vendosë për çështjet e kontratës midis kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor
- 8.2 Drejtuesi i Projektit mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij tek të tjerët përveç zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe konflikteve. Drejtuesi i projektit duhet të njoftojë kontraktorin për delegimet e bëra apo të revokuara.

Neni 9: Komunikimi

- 9.1 Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

Neni 10: Bashkepunimi në Kantier me të Tjerët

- 10.1 Kontraktori duhet të bashkepusojë dhe të ndajë kantierin me firma të tjera, autoritete publike, shërbimet publike dhe Autoritetin Kontraktor siç kërkohet dhe përkufizohet në Grafikon e realizimit të punimeve.

Neni 11: Përgjegjësia e Autoritetit Kontraktor

11.1 Autoriteti Kontraktor ka përgjegjësi të kompensojë kontraktorin për dëmtime të pajisjeve të kontraktorit deri në masën që lidhet me veprime me faj të Autoritetit Kontraktor ose të projekteve të Autoritetit Kontraktor me perjashtim të rastit kur keto të fundit, kishin gabime të dukshme që mund të ishin konstatuar lehtësisht nga kontraktuesi.

Neni 12: Raporti i Inspektimit të Kantierit dhe Kushtet e Kantierit

12.1 Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për konkluzionet ose interpretimet e bëra në raportin e inspektimit të kantierit.

12.2 Kontraktori pranon se i ka marrë të gjitha hapat e nevojshme për të verifikuar natyrën dhe vendin e Punimeve dhe se ka inspektuar dhe pajtohet me kushtet e përgjithshme dhe lokale që mund të ndikojnë në kryerjen ose koston e Punëve.

Neni 13: Kontraktori që Kryen Punimet

13.1 Kontraktori duhet të kryejë dhe mbarojë Punimet në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit.

13.2 Kontraktori nuk mban përgjegjësi për gabimet në projekt, të dhëna, planimetri ose aspekte të tjera të specifikimeve teknike, të dhëna nga Autoriteti Kontraktor, me perjashtim të rasteve kur gabimi ishte aq i dukshëm sa kontraktori duhet ta kishte vënë re dhe ta kishte reklamuar këtë të Autoriteti Kontraktor.

13.3 Kodet dhe standartet që do zbatohen do të jenë të shprehura në dokumentat e tenderit. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në zbatimin e kodeve ose standarteve, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pasi të jenë aprovuar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 14: Ekzekutimi i Punimeve

14.1 Kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë sapo ta lidhë atë dhe duhet t'i mbarojë Punët brenda Afatit të Mbarimit.

Neni 15: Ngritja e Kantierit

15.1 Kontraktori mban përgjegjësi për projektin e Ngritjes së Kantierit.

15.2 Kontraktori duhet të paraqesë të gjitha planet për Ngritjen e Kantierit tek drejtuesi i projektit për shqyrtimin dhe miratimin e tij.

Neni 16: Sigurimi Teknik dhe Mjedisor

